



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



Në mbështetje të nenit 6.2 të Rregullores për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje nr. 01-35-15-1449 dt. 23.07.2009, Komuna e Prishtinës, bënë këtë

SH P A L L J E P U B L I K E

Njoftohen të gjithë investitorët (qytetarët dhe bizneset) e përfshirë në ndërtime pa leje brenda territorit të Komunës së Prishtinës, se me dt. 19.08.2010, në ora 10:30 është bërë incizimi (imazhi) satelitor i gjendjes faktike të objekteve ndërtimore.

Kërkesat për përfshirje në regjistrin e ndërtimeve pa leje paraqiten nga data 1 shtator 2010 deri me 31 tetor 2010. Kërkesat kanë të drejt t'i paraqesin vetëm ata që janë përfshire në imazhin satelitor të datës 19 gusht 2010, ora 10:30

Çdo ndërtesë apo pjesë e saj e ndërtuar pas datës 19 gusht 2010 dhe që nuk figuron në imazhin satelitor të kësaj dite nuk do të mund t'i nënshtrohet procedurës se legalizimit .

Kërkesat për trajtimin e ndërtimeve pa leje dorëzohen në Zyrën Pritëse të Komunës së Prishtinës, zyra nr. 7, rr. " UÇK" nr. 2.

Formularët e kërkesave për legalizim të objekteve të ndërtuara pa leje mund të tërhiqen në Zyrën Pritëse apo në web faqen Komunës së Prishtinës www.prishtina-komuna.org .

Secili ndërtim pa leje pas kësaj date, do të trajtohet konform me dispozitat e Ligjit për Ndërtim nr. 2004/37 dhe akteve tjera nënligjore të nxjerra në bazë të këtij Ligji përkatësisht, ato ndërtime do të rrënohen.